

## Strategji për të ardhmen: Mënyra të reja të planifikimit të luftës kundër korrupsionit

Procesi nga projektimi deri në prodhimin e një automjeti të ri zgjat rreth dhjetë vjet. Për inxhinierët dhe dizajnerët, truku është të bëjnë automjet jo për konsumatorët sot, por për tregun ashtu siç mund të jetë një dekadë nga tani. Ky proces zakonisht quhet foresight ndërsa në vendin tonë në këtë kuptim do ta përkthenim si largpamësi. Qëllimi, absolutisht nuk është të parashikohet e ardhmja, por nëpërmjet një procesi të të menduarit të imagjinohen disa të ardhme të mundshme.

Në vendin tonë, në krijimin e politikave publike, zhvillimi i planeve strategjike si pikënisje ka të tashmen. Analiza përfshin problemet aktuale, gjendjet dhe kapacitetet mbi bazën e të cilave krijohen aktivitetet. Procesi i planifikimit strategjik është një pjesë e rëndësishme dhe e domosdoshme e qeverisjes së mirë. Marrja e vendimeve jashtë kornizës strategjike sjell një dozë arbitrariteti dhe paparashikueshmëri gjatë planifikimit.

Megjithatë, planifikimi strategjik i rrënjësuar në të sotmen, vështirë i parashikon problemet që nuk ekzistojnë sot, ose problemet që ne i ndiejmë, por që janë të vështira për t'u parashikuar. Prandaj, ato shpesh mungojnë në planet strategjike. Largpamësia si metodë e planifikimit nuk merret me parashikimin. Përkundrazi, pasuria e largpamësisë paraqet përfshirjen e skenarëve të mundshëm së bashku, për të mundësuar përshtatshmërinë e organizatave ndaj më shumë skenarëve. Për shembull, nëse në vitin 2019 planifikonim se si do të zhvilloheshin investimet e huaja në Ballkanin Perëndimor, nëse merrnim parasysh skenarët e mundshëm, asnjëri prej tyre nuk do të përmbante pandemi globale, apo një ngjarje të ngjashme që shkakton çrregullime thelbësore. Por me analizë të mirë largpamëse, me siguri do të përfshini ngjarje me përmasat e çrregullimeve radikale, në mënyrë që një vizion i tillë për të ardhmen sot të jetë më i besueshëm për planifikim. Kjo është arsyeja, pse planifikimi largpamës është i rëndësishëm në krijimin e politikave publike, sepse ofron një dimension shtesë dhe rrjedhimisht politikëbërje të përgjegjshme për të mirën e brezave të ardhshëm.

Por, bërja e strategjisë nga pozicioni i së ardhmes ka vlerë të shtuar kur zbatohet për antikorrupsionin. Jo vetëm që udhëhiqet nga kapacitetet e ardhshme, por veprimi antikorrupsion duhet të përgatitet edhe për format e ardhshme që mund të ketë korrupsioni. Kështu, lufta kundër korrupsionit duhet të përgatitet për një sërë skenarësh të mundshëm, si për shembull suksesi ose dështimi i "Ballkani i Hapur" dhe efektet pozitive dhe negative të këtij integrimi dhe derregullimi të tregut, suksesi ose dështimi i krypto-monedhave, migrimi dhe kapitali njerëzor, sukseset apo dështimet në luftën kundër krimit të organizuar dhe shumë faktorë të tjerë, vendas dhe të huaj, që ndikojnë në korrupsionin dhe zhvillimin institucional në vend.

Projekti "Biseda anti -korrupsion në Kuvend (Anti-Corruption Talk in Parliament (ACT in Parliament)) përfshin aktivitete kërkimore dhe përfaqësuese me qëllim kryesor, mbështetjen e procesit reformues në Maqedoninë e Veriut, përmes forcimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit në luftën kundër korrupsionit.

Projekti mbështetet nga Fondi Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për përmbajtjen është përgjegjës IDSCS dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pozicionet e Fondit Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy- NED).